



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DIVJAKE

Divjake me 21/07/2017

Nr. 3418
dt. 21-07-17

VENDIM

NR. 49/, DATË 21/07/2017

Mbeshtetur ne ligjin Nr.139/2015 date 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, VKM Nr.63 date 17.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.” Statutit të Ujesjelles – Kanalizime Sh.a”,

VENDOSI:

1. Te miratoje Znj.Eleda Dhima ekspert kontabel e licensuar per kryerjen e procedures se inventarizimit dhe hartimit te raportit per procesin e rritjes se kapitalit.

KRYETARI

FREDI KOKONESHI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DIVJAKE
KRYETARI

Kopje e origjinalit me origjinalin

Divjake me 31/1/2018

Nr. 360P

VENDIM

NR. 100, DATË 31/1/2018



Mbeshtetur ne ligjin Nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", VKM Nr.63 date 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura. VKM Nr. 510 date 10.05.2015 " Per miratimin e procedurave per transferimin e te drejtave e detyrimeve, personelit, aktiveve te trupezuara e te pa trupezuara, te arkivave dhe te cdo dokumenti zyrtar ne njesite e qeverisjes vendore te prekura nga riorganizimi administrativo-territorial, Statutit te Ujesjelles –Kanalizime Sh.a",

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit lidhur mbi Zmadhimin e Kapitalit te Shoqerise Ujesjelles-Kanalizime Sh.a Divjake
2. Shtimin e Kapitalit prej **234 965 000 leke**, nga **120 130 000 leke** behet **355 095 000 leke** i ndare ne aksione **355 095 aksione me vlere nominale 1000 leke**.
3. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6 e ligjit Nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore"
3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Ujesjelles - Kanalizime Sh.a Divjake

Perfaqesues i Asamblese se Pergjithshme se Ujesjelles Kanalizime SH.A Divjake



Fredi KOKONESHI

RAPORT LIDHUR ME
ZMADHIMIN E KAPITALIT
TE SHOQERISE “Ujesjelles - Kanalizime” SHA
Bashkia Divjake

Drejtuar aksionereve te shoqerise

Ne zbatim te detyres qe me eshte ngarkuar nga Keshilli Bashkise Divjake me vendimin nr 55 date 21.07.2017 dhe Asambleja e Aksionereve te shoqerise “Ujesjelles-Kanalizime” SHA Bashkia Divjake , une, Eleda Dhima , Audituese Ligjore me nr licence nr 197 date 30.01.2009 dhe me nipt K93819401P, kam kryer misionin ne lidhje me hartimin e Raportit per vleresimin e zmadhimit e kapitalit te regjistruar te Shoqerise “Ujesjelles - Kanalizime” SHA Bashkia Divjake nepermjet kontributit ne natyre .

Zmadhimi i Kapitalit te Themeltar te Shoqerise, behet ne respektim te Ligjit, Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare”, Nenet : 1, 82,83,87,90, ligjit nr 139/2015 date 17.12.2015 “Per vetqeverisjen vendore, VKM nr 63 date 27.01.2016 “Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin me uje te pishem, grumbullimin, largimin e trajtimin e ujrave te ndotura”, VKM 510 date 10.05.2015 “Per miratimin e procedurave per transferimin e te drejtave e detyrimeve, personelit, aktiveve te trupezuara e te patrupezuara, te arkivave dhe te cdo dokumenti zyrtar ne njesite e qeverisjes vendore, te prekura nga riorganizimi administrativo-teritorial.”

Te Pergjithshme

Shoqeria “Ujesjelles - Kanalizime” SH.A. Bashkia Divjake eshte themeluar si nje shoqeri anonime sipas urdherit nr 579 date 18.06.2013 te Ministrise Ekonomise, Tregtisë dhe Energjetikës dhe eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me nipt K63731401A .

Kjo shoqeri vepron ne sektorin prodhimit dhe shpërndarjes se ujit të pijshëm. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja, krijimin e sipërmarrjeve të tjera dhe pjesëmarrje të tjera, si brenda ashtu edhe jashte vendit.

Kapitali rregjistruar eshte 120 130 000 leke me 120 130 aksione e me vlere nominale 1000 leke /aksioni dhe zotrohet nga aksioneri i vetem Bashkia Divjake.

Kapitali i Shoqerise ne date 31.12.2016, paraqitet si me poshte:

Kapitali i Nënshkruar	120 130 000
Rezerva të tjera	21 00 926
Humbje e mbartur	- 17 290 741
Fitim / Humbja e Vitit	- 5 143 065
Totali i Kapitalit	118 897 120

Shoqeria eshte krijuar dhe ushtron aktivitetin e saj ne baze te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe legjislacionit tjeter ne fuqi.

Ne zbatim te ligjit dhe neneve te sipercituara dhe duke u bazuar ne Vendimin e Asamblese se Aksionereve te shoqerise nr 55 data 21.07.2017 pika 1 e rendit te dites, eshte vendosur qe te rritet kapitali i shoqerise me vleren e ujesjellesave te zonave te cilat kane qene ne administrim te Njesive Administrative Grabian, Gradisht(Gorica, Fierseman,Kemishtaj), Kabinat dhe pompat Cerme Shkumbin(pjese e ujesjellesit Shenepremte) dhe Ujesjellesi Plazh Divjake ne administrim te Bashkise Divjake. Te gjitha vlerat kontabel te ketyre ujesjellesave jane te pasyruara ne pasqyren shoqeruese te vleresimit. Sipas permbledheses ku jane vleresuar te gjitha asetet dhe jane llogaritur amortizimet sipas viteve ne funksion, vlera e mbetur eshte 234 965 000 leke.

Zmadhimi i Kapitalit, shkakut dhe masa e zmadhimit.

Zmadhimi i kapitalit te Shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" SHA Bashkia Lushnje do te shoqerohet me zmadhimin e aktiveve afatgjata materiale me shumen e vleresuar prej 234 965 000 leke. Per te saktësuar veprimet paraqesim gjendjen aktuale te pasqyrave financiare te shoqerise.

Ne aktiv te bilancit jane paraqitur aktivet afatshkurtra materiale dhe aktivet afatgjata materiale. Ne pasiv te Bilancit jane paraqitur detyrimet afatshkurtra dhe Kapitalet Veta, si dhe struktura e saj "Fitime/Humbje" ushtrimore (deri me 31.12.2016) , qe pasqyron diferencat midis totalit te te ardhurave te realizuara dhe shpenzimet e ushtrimit te Shoqerise.

Bilanci Kontabel qe mbyllet me 31.12.2016 ,ka te dhenat e meposhtme:

<u>Aktivitet</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Aktive Afatgjata materiale	124 905 335	125 893 293
Aktive Afatshkurtra	12 042 252	9 297 287
Totali i Aktiveve	136 947 587	135 190 580
	=====	=====

Pasivi

Kapital i nenshkruar	120 130 000	120 130 000
Rezerva te tjera	21 200 926	21 200 926
Humbje e mbartur	- 17 290 741	- 9 731 628
Fitimi neto	- 5 143 065	- 7 559 113
Shuma	118 897 120	124 040 185
 Detyrime te kerkueshme	 18 050 467	 11 150 395
 Totali I pasiveve	 136 947 587	 135 190 580
	=====	=====

Bilanci eshte i rakorduar dhe ka te saktesuara pozicionet kontabel te aktiveve afatgjata materiale si dhe te kapitalit te regjistruar mbi te cilat do te kete efekte ne rritje te vleres ne menyre te barabarte, ky vleresim e regjistrim kapitali.

Sipas vendimit te aksionereve te shoqerise eshte vendosur qe sipas vleresimit te kryer, te pergatis raportin per te bere te mundur regjistrimin ne aktivet afatgjata materiale, te llojit ujesjellesa ne aktivet afatgjata te shoqerise sipas listes se meposhteme:

Pasqyra permbledhese e vleresimit kontabel te aktiveve afatgjata qe kalojne ne						
shoqerine Ujesjelles Kanalizime SHA Bashkia Divjake						
Nr	Kodi i Aseteve	Perllogaritja e Vleres Kontabel				
		Vlera fillestare ne kontabilitet (Leke)	Amoritizimi i Akumuluar (Leke)	Vlera e Mbetur Kontabel (Leke)	Siperfaqe e tokes ne perdorim	Vlera e tokes (Leke)
1	Ujesjellesi Grabian	16,370,211	1,526,522	14,843,689	1,400	509,600
2	Ujesjellesi Stravec	3,500,000	326,430	3,173,570		
3	Ujesjellesi Treurat	4,297,467	400,739	3,896,728		
4	Stacion pompe K10/651	150,000	13,988	136,013		
	Njesia Adm. Grabian	24,317,678	2,267,678	22,050,000	1,400	509,600
1	Ujesjellesi Kemishtaj	37,333,430	11,820,430	25,513,000		
2	Ujesjellesi Fierseman	4,552,935	1,180,935	3,372,000	400	145,600
3	Ujesjellesi Goriçaj	31,912,607	12,407,607	19,505,000	400	145,600
	Njesia Adm.Gradishte	73,798,972	25,408,972	48,390,000	800	291,200
	Ujesjellesi Plazh Divjake	187,940,991	23,415,991	164,525,000	-	-
	Totali	286,057,641	51,092,641	234,965,000	2,200	800,800

Nga tabela saktesohet se vlera fillestare e ujesjellesave te zonave qe i bashkohen shoqerise Ujesjelles kanalizime SHA Bashkia Divjake eshte 286 057 641 leke nga te cilat eshte zbritur amortizimi i llogaritur prej 51 092 641 leke dhe vlera e mbetur aktualisht eshte 234 965 000 leke. Kjo vlere duhet eshte ne fakt shuma e rritjes se kapitalit dhe e aktiveve afatgjata materiale.

Vec kesaj vlere duhej te ishte edhe vlera tokes me siperfaqe 2200 m2 e cila e vleresuar me cmimin e tokes bujqesore 364 leke/ m2 (sipas VKM nr 89 date 03.02.2016) arrin

vleren prej 800 800 leke e cila duke qene e pa regjistruar ne ZVRPP, mendoj se duhet te kaloj ne perdorim te shoqerise, derisa te behet i plote dokumentacioni perkates.

Ne vendimin e Keshillit Bashkise Divjake nr 55 date 21.07.2017 kerkohet edhe kalimi i asetave gabina e pompa Çërme shkumbin, pjese te ujesjellet Sheneprerme, por meqenese per keto objekte nuk ka vlere te regjistruar kontabel, nuk jane trajtuar ne ktete raport rritje kapitali.

Pra nga ana e Audituesit Ligjor u verifikuan shkaku dhe modalitet e zmadhimit si:

1. Burimi i zmadhimit te kapitalit jane aktivet afatgjata materiale sipas listes bashkelidhur te ujesjellesave te zonave qe deri tani kane qene ne administrim te pushtetit vendor dhe qe do te kalojne ne administrim te shoqerise "Ujesjellet Kanalizime" SHA Bashkia Divjake.
2. Operacioni i zmadhimit sjell rritjen vleres se kapitalit te nenshkruar si dhe rritjen e aktiveve afatgjata materiale ne shumen 234 965 000 leke.

Aktivete afatgjata te shoqerise do te shtohen me shumen 234 965 000 leke sipas zerave te mesiperme dhe shuma e aktiveve afatgjata materiale te shoqerise arrin ne 359 870 335 (124 905 335+ 234 965 000) leke dhe per te njejtën shume zmadhohet kapitali themeltar i shoqerise sepse keto aktive jane prone publike, kontribut ne natyre, qe kalon ne administrim te shoqerise Ujesjellet kanalizime SHA Bashkia Divjake .

Kapitalet e veta te shoqerise do te rriten nga kontributi ne natyre me 234 965 000 leke

Pra ne total kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 355 095 000 leke qe eshte rezultat i kapitalit te regjistruar 120 130 000 leke dhe i kontributit ne natyre te ujesjellesave te zonave qe deri tani kane qene ne administrim te pushtetit vendor per shumen prej 234 965 000 leke i cili do te jete i ndare si me poshte:

Kapitali i Nenshkruar	355 095 000 (120 130 000+ 234 965 000)
-----------------------	--

Rezerva të tjera	21 200 296
Humbje e mbartur	- 17 290 741
Fitim / Humbja e Vitit	- 5 143 065
Totali i Kapitalit	353 861 490

(Treqindepesedhjetetremijeteteqindegjashtedhjetenjemijekaterqindenenedhjetete)

Konkluzion

- **Kapitali i regjistruar i shoqerise behet 355 095 000 leke i ndare ne 355 095 aksione me vlere nominale 1000 leke.**

-Ky kapital ne vleren e mesiperme eshte i argumentuar dhe i garantuar me masen e aktiveve neto te shoqerise , ashtu sic paraqiten ne bilancin kontabel qe mbyllet me 31.12.2016 dhe ne vleresimet me vleren e drejte per aktivet afatgjata materiale te shoqerise te cilat do te jene pjese e aktiveve te bilancit kontabel te vitit 2017.

-Raporti i perpiluar nga une me cilesine e Audituesit Ligjor, per zmadhimin e kapitalit te Shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" SHA Bashkia Divjake . lidhur me perfshirjen e kontributit ne natyre te aktive afatgjata materiale,eshte bazuar ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit , Standartet Nderkombetare te Auditimit dhe ne respektim te legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

- Pjese e ketij raporti eshte edhe pasqyra bashkelidhur .

Audituese Ligjore

Eleda Dhima

Date 14.12.2017.

Lagjja "Xhevdet Nepravishata" Lushnje

Cel: 069 40 98 121

E-mail: eledadh@yahoo.it





REPUBLIKA E SHQIPERISE
QENDRA E REGJISTRIMIT TE AKSIONEVE SH.A.
TIRANE

EKSTRAKTI I REGJISTRIT TE AKSIONEVE

SH.A. Ujësjetellës-Kanalizime - DIVJAKË

Gjendja më datë 11.02.2018

Kapitali themeltar 355.095.000 LEK

Vlera nominale / aksion 1.000 LEK

Totali i Aksioneve 355,095

Numri i Aksionerëve 1

Numri i Aksioneve të mbetura .. 0

Për QRA

ARLJATI MYSLIMAJ

CM

Adresa: Rr. "George W. Bush" Nr.13
Kutia Postare: 7424 - Tiranë
Tel: ++355 / 4 / 233425
Fax / Modem: ++355 / 4 / 233442

Vendimi i Gjykatës: Nr.14253 Dt. 21/03/96
Kodi Fiskal: K314 22103G
Nr. Llogarisë: 0200 355
BKT Dega Nr.2 Tiranë

Numri i Aksionerëve : 1

Numri i faqeve: 2

NR.	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	LINDUR ME	VENDLINDJA	AKSIONE	%	ADRESA	QYETI	RRETHI
1	BASHKIA	-	DIVJAKË	01.01.2001	DIVJAKE	355.095	100.000%	Bashkia Divjake	DIVJAKE	LU
TOTALI =						355.095	100.000%			

